



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 44

Tiranë – E premte, 19 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 12024, datë 17.3.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5099
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 157, datë 11.3.2021	Për një shtesë dhe disa ndryshime në urdhrin nr. 53, datë 31.1.2020 “Për ngritjen e komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirus i ri” 5099
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 158, datë 11.3.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020 “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”..... 5099
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 11.2.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2017-819, datë 25.5.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2048, datë 12.10.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 6953, datë 23.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë..... 5100
	Ndreqje gabimi material në nenin 132, të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, viti 2020..... 5106
	Kërkesë për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së të ndjerit Zef Zefi..... 5107

**DEKRET****Nr. 12024, datë 17.3.2021****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre këtyre personave:

1. Adrion Nehat Pajaziti
2. Nedim Seip Bajrami

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

URDHËR**Nr. 157, datë 11.3.2021**

**PËR NJË SHITESË DHE DISA
NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 53,
DATË 31.1.2020 “PËR NGRITJEN E
KOMITETIT TË PËRKOHSHËM PËR
INFEKSIONIN E PËRHAPUR NGA
CORONAVIRUS I RI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 33, germa “ë”, të ligjit nr. 15, datë 10.3.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 53, datë 31.1.2020 “Për ngritjen e komitetit të përkohshëm për infeksionin e

përhapur nga coronavirus i ri”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 të urdhrit, bëhen zëvendësimet e anëtarëve si më poshtë vijon:

“f) Znj. Najada Çomo, zëvendësohet me znj. Ermira Kola, shefe e Shërbimit të Reanimacionit Pediatrik, QSUT;

g) Z. Tritan Kalo, zëvendësohet me z. Dhimitër Kraja, mjek infeksionist;

l) Znj. Narvina Sinani, zëvendësohet me znj. Jetmira Bebeci, drejtor AKBPM”.

2. Në pikën 2 të urdhrit, pas germës “l” shtohet germa “ll” me këtë përmbajtje:

“ll) Z. Alban Ylli, shef i Sektorit të Sëmundjeve Kronike dhe Politikave të Shëndetit ISHP, anëtar”.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR**Nr. 158, datë 11.3.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 633, DATË 17.11.2020 “PËR
NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE
NË VENDE TË MBYLLURA APO
TË HAPURA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, si edhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 1356, datë 11.3.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, togfjalëshi “deri në një urdhër të dytë” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në datën 25.3.2021”.



2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 2, datë 11.2.2021

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “
Altin Binaj	anëtar i “ “
Përparim Kalo,	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.2.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 13 (F)/2017 regj.them., që u përket:

KËRKUES: Fedhon Meksi, Petrit Skënde, Elvin Skënde, Andi Skënde.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, Zyra Vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme nr. 3 e punëtorëve të qytetit të Tiranës, Hyrije Gavoci, Petrit Gavoci, Djana Gavoci, Fatime Luzi, Burbuqe Plasari, Eduart Plasari, Rea Plasari.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2017-819, datë 25.5.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 2048, datë 12.10.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 6953, datë 23.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 142 dhe 181 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 28, 29, 30 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit të Tiranës, i cili u qëndron parashtrimeve të paraqitura në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Sipas akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuësit, në cilësinë e trashëgimtarëve të ish-pronarit Vangjel Meksi, i janë drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (AKKP) për njohjen dhe kthimin e pasurisë truall me sipërfaqe 1100 m² dhe të banesës dykatëshe të ndërtuar mbi të, të ndodhur në Tiranë. Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, me vendimin nr. 169, datë 22.6.2009, ka deklaruar mungesën e juridiksionit për trajtimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuësit. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë paraqitur ankim pranë drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së.

2. Me vendimin nr. 66/33, datë 18.1.2013, AKKP-ja ka deklaruar mungesën e juridiksionit administrativ dhe të kompetencës së saj për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1931, datë 26.2.2013, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Anulimin e vendimit nr. 169, datë 22.6.2009 të ish-zyrës rajonale Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë dhe të vendimit nr. 66/33 prot., datë 18.1.2013 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë. Detyrimin e palës së paditur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë që të shprehet në themel si organ kompetent për kërkesën e paditësit Fedhon Meksi për kthimin/kompensimin e pronës.”.

4. Në rishqyrtimin e kërkesës, AKKP-ja, me vendimin nr. 1192, datë 4.9.2013, ka vendosur:



“Rrëzimin e kërkesës për njohje dhe kthim të pronës... të pretenduar nga trashëgimtarët e Vangjel Meksit.”

5. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt anulimin e vendimit nr. 1192, datë 4.9.2013 të AKKKP-së Tiranë, detyrimin e subjekteve të interesuara t'i njohin pronarë të pasurisë truall dhe banesës dykatëshe, si dhe kthimin e pasurisë, vërtetimin e mosqenies së marrëdhënies juridike të së drejtës së pronësisë të subjekteve të interesuara etj.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6953, datë 23.9.2015, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë.”*

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2048, datë 12.10.2016, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 6953, datë 23.9.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2017-819, datë 25.5.2017 ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmban asnjërin prej rasteve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

9. Me kërkesën e datës 21.9.2017 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës së pronës private dhe asaj për një proces të rregullt gjyqësor nga vendimmarrja e gjykatave të të tria shkallëve të gjykimit.

10. Me vendimin e datës 23.11.2017, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

11. Me vendimin e datës 12.12.2017, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

12. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të kërkesës, duke pretenduar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar:

12.1 Të drejtën e pronës private, pasi vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së apelit nuk janë bazuar në provat e administruara gjatë

gjykimit. Gjykatat pranojnë faktin se pasuria objekt gjykimi nuk është shtetëzuar, për pasojë kërkuesit nuk janë subjekt i ligjit, ndërsa provat provojnë të kundërtën, pra se kjo pasuri është shtetëzuar në vitin 1949 nga regjimi i asaj kohe. Të drejtat e pronësisë janë fituar sipas ligjit të kohës dhe vetëm fakti se prona nuk është transkriptuar, nuk do të thotë se kërkuesit nuk gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi të.

12.2 Standardin e arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, pasi edhe pse në rekurs janë paraqitur shkaqe për të cilat duhej të ishte vendosur shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore, në pjesën arsyetuese të vendimit nuk janë paraqitur argumentet se përse është vendosur mospranimi i tij.

12.3 Parimin e sigurisë juridike, pasi gjykata të ndryshme kanë bërë vlerësime të ndryshme në lidhje me çështjen e shpronësimit të kërkuesve.

12.4 Parimin e paanshmërisë, pasi çështja e kërkuesve është shqyrtuar jashtë radhës në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që ata nuk kanë kërkuar përshpejtimin e saj. Çështja është shqyrtuar në atë gjykatë në më pak se 90 ditë.

12.5 Standardin e gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pasi proceset gjyqësore për çështjen e kërkuesve kanë zgjatur për rreth 19 vjet.

13. Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë, në parashtrimet e tij është shprehur se u qëndron parashtrimeve të paraqitura gjatë gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm se prona është ndërtuar dhe më pas është privatizuar nga persona të tjerë, ndaj kërkesëpadi duhet të rrëzohet, dhe kërkon që këto qëndrime të merren parasysh edhe në Gjykatën Kushtetuese.

14. Subjektet e tjera të interesuara nuk kanë paraqitur parashtrime pranë kësaj Gjykate, edhe pse janë njoftuar rregullisht me shpallje për këtë gjykim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

15. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje në seancë plenare.

*A. Për legjitimitimin e kërkuësve*

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

17. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Gjykata vlerëson se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

19. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës për cenimin e të drejtave kushtetuese, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton që ai duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuësi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Po ashtu, edhe pretendimet e parashtruara në kërkesë janë paraqitur më parë në instancat e zakonshme

gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural.

20. Kërkuësit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit i gjykatave të zakonshme, ai i Gjykatës së Lartë, është i datës 25.5.2017, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 21.9.2017, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

21. Në lidhje me pretendimet e kërkuësve, Gjykata çmon se *prima facie* ato hyjnë në juridiksionin e saj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës private

22. Kërkuësit pretendojnë se vendimi i gjykatës së apelit dhe vendimi i gjykatës së rrethit nuk janë bazuar në provat e administruara gjatë gjykimin. Gjykatat pranojnë faktin se pasuria, objekt gjykimi, nuk është shtetëzuar, për rrjedhojë kërkuësit nuk janë subjekt i ligjit, ndërsa provat provojnë të kundërtën, pra që pasuria është shtetëzuar në vitin 1949 nga regjimi i asaj kohe. Të drejtat e pronësisë janë fituar sipas ligjit të kohës dhe, si të tilla, ato janë të rregullta. Vetëm fakti se prona nuk është transkriptuar nuk do të thotë se kërkuësit nuk gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi të. Si rrjedhim, procesi gjyqësor i kundërshtuar u ka cenuar kërkuësve të drejtën e pronës private.

23. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimin kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 7, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr.13, datë 10.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë



prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Referuar kërkesës, Gjykata konstaton se për pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private kërkuarit kanë paraqitur argumente të përgjithshme, me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese. Gjykata rithekson se vlerësimi i fakteve dhe provave, si dhe interpretimi i ligjit janë çështje që nuk hyjnë në juridiksionin e kësaj gjykate por në atë të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Gjykata vëren se kërkuarit, për të njëjtat shkaqe të parashtruara për këtë pretendim, kanë kërkuar shfuqizimin e të tria vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuarit nuk kanë arritur të provojnë cenimin e së drejtës së pronës private nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë ky pretendim është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

25. Sipas kërkuarve, rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë përmbante shkaqe dhe argumente që kishin të bënin me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, të cilat gjejnë pasqyrim edhe në materialet e dosjes gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë, duke mos pasqyruar në vendim dhe duke mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet

gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë dhe përmban referenca në ligjin e zbatueshëm (*shih vendimet nr. 24, datë 25.4.2016; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këtë kontekst, nuk është detyrë e kësaj Gjykate të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 27, datë 27.3.2017; nr. 84, datë 30.12.2016; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 22, datë 6.6.2011; nr. 19, datë 19.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuarit, me argumentin se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

31. Po ashtu, Gjykata konstaton se në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkuarit kanë ngritur, në thelb, këto pretendime: është provuar se prona është shtetëzuar, ndryshe nga sa kanë konkluduar gjykatat; banesa e ish-pronarit Vangjel



Meksi nuk ka qenë në rrugën “Jul Variboba”, por në rrugën “Lek Dukagjini”; ndërtimi i shtëpisë dykatëshe është bërë vetëm nga Vangjel Meksi dhe jo nga të tjerë; kontratat e privatizimit që kanë bërë paditësit janë absolutisht të pavlefshme; Kodi Civil i kohës e ndalonte regjistrimin e pronësisë; gjykatat janë kontradiktore në vendimet e tyre lidhur me faktin e pronësisë për sa i përket trashëgimlënësit Vangjel Meksi; thëniet e dëshmitarëve dhe gjykimet e vërtetimit të faktit nuk mund të shërbejnë si prova; nuk ka asnjë provë që të vërtetojë kalimin e pronësisë nga Vangjel Meksi te persona të tjerë etj. Gjykata vëren se këto pretendime kanë gjetur vend, në mënyrë të përmbledhur, në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, çka respekton në kuptimin formal, elementet e sipërcituara të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

32. Gjykata ka vlerësuar se në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe për këtë arsye shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që u jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, duke pasur parasysh edhe natyrën e gjykimit në këtë fazë të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë

nuk cenon në vetvete standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarësve është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

34. Sipas kërkuarësve ky parim është cenuar pasi gjykata të ndryshme kanë bërë vlerësime të ndryshme në lidhje me çështjen e shpronësimit të tyre.

35. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Edhe në lidhje me parimin *res judicata*, Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimin nr. 50, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata ka çmuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 50, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke iu referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vlerëson të pasqyrojë proceset gjyqësore që janë zhvilluar nga palët ndërgjyqëse të procesit gjyqësor të kundërshtuar. Gjykata vëren se subjektet e interesuara me anë të vendimeve nr. 3240, datë 8.11.1999 dhe nr. 1483, datë 27.4.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë privatizuar një banesë nga Ndërmarrja Komunale



Banesa (NKB) dhe një sipërfaqe truall që i përket oborrit të shtëpisë. Pas këtyre privatizimeve, ndërmjet subjekteve të interesuara dhe NKB-së janë lidhur edhe kontratat e shitjes. Njëri prej kërkuessve (shtetasi Fedhon Meksi) ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt “Kundërshtimi i të tretit”, duke kundërshtuar kontratën e privatizimit të banesës ndërmjet subjekteve të interesuara dhe NKB-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1371, datë 5.5.2000, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesëpadisë. Kundërshtimin e vendimit nr. 3240, datë 8.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa i përket privatizimit të banesës...*”. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 96, datë 1.2.2001, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se shtetasi Fedhon Meksi legjitimohej t’i drejtohej gjykatës vetëm nëse do të dispononte një vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që provon titullin e pronësisë mbi pronën e pretenduar.

37. Në vitin 2011 shtetasi Fedhon Meksi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 96, datë 1.2.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke parashtruar si shkak rishikimi zbulimin e disa provave të reja me shkresë, që kanë rëndësi për çështjen, që nuk direshin gjatë shqyrtimit të çështjes dhe që vërtetojnë se vendimi është i padrejtë e duhet të prishet. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2673 (562), datë 6.12.2012, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë. Prishjen e vendimit nr.96, datë 1.2.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 1371, datë 5.5.2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, por me trup tjetër gjykes?*”.

38. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se proceset gjyqësore të sipërcituara janë të ndryshme nga procesi objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë dhe ato janë iniciuar nga kërkuessit, me mjetet procedurale të vlerësuara prej tyre, duke pasur si objekt “kundërshtimin e të tretit” dhe kërkesën për rishikim. Për të realizuar pretendimin për të drejtën e pronësisë mbi banesën, përdorimi i mjeteve juridike nga kërkuessit i ka dhënë shkak proceseve të tjera gjyqësore dhe asnjë nga vendimet e dhëna në përfundim të tyre nuk ka qenë përfundimtar për të drejtën e pronës (të ndërtesës). Në mënyrë

përfundimtare, Gjykata çmon se nuk kemi të bëjmë me procese paralele dhe as me fakte të vlerësuara në mënyra të ndryshme në proceset gjyqësore.

39. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuessve është i pabazuar.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

40. Kërkuessit pretendojnë se është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi çështja e tyre është shqyrtuar jashtë radhës në Gjykatën e Lartë, në më pak se 90 ditë, pa pasur kërkesë për përshpejtimin e saj.

41. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por edhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 6, datë 29.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Duke iu referuar çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve, nuk rezulton që kërkuessit të kenë paraqitur ndonjë provë për të mbështetur pretendimin e tyre. Periudha e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk është fakt i mjaftueshëm për të mbështetur pretendimin për paanshmëri, në kuptimin subjektiv, për më tepër që rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me anë të rekursit të ushtruar nga vetë kërkuessit. Për sa i përket paanshmërisë objektive, Gjykata vlerëson se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve të çështjes. Pretendimet e kërkuessve për cenim të këtij parimi nuk janë të mjaftueshme për të arritur arritur në përfundimin se ka patur njëanshmëri të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, pasi kërkuessit nuk kanë paraqitur asnjë provë tjetër për të mbështetur këtë pretendim. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuessit nuk kanë arritur të argumentojnë cenimin e këtij parimi në aspektin objektiv ose subjektiv të tij, për rrjedhojë edhe ky pretendim është i pabazuar.



DH. Për pretendimin e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm

43. Kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pasi proceset gjyqësore kanë zgjatur rreth 19 vjet.

44. Gjykata vëren se kërkesat për mosgjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm në jurisprudencën e Gjykatës janë trajtuar në këndvështrim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe individit është legjitimuar për të tilla pretendime pasi legjislacioni në fuqi nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja procedurale (ndryshimet e KPC-së të vitit 2017, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017), çështjet për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ku përfshihet edhe mosgjykimi brenda një afati të arsyeshëm, shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme dhe nuk bëjnë më pjesë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Duke qenë se çështja e kërkuesve ka përfunduar në Gjykatën e Lartë në datën 25.5.2017, pra përpara hyrjes në fuqi të dispozitave të reja procedurale, dhe ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 21.9.2017, Gjykata vlerëson të marrë në shqyrtim edhe këtë pretendim.

46. Gjykata vëren se procesi gjyqësor për të cilin kërkuesit kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ka nisur në vitin 2014, me kërkesëpadinë e paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila është ka marrë vendimin nr. 6953, datë 23.9.2015. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim kërkuesit dhe gjykata e apelit, pasi ka përfunduar shqyrtimin e çështjes, ka dhënë vendimin e datës 12.10.2016. Kërkuesit kanë bërë rekurs kundër këtij vendimi dhe Gjykata e Lartë është shprehur për çështjen me vendimin e datës 25.5.2017. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se i gjithë procesi gjyqësor për të cilin kërkuesit kanë paraqitur pretendime nëpërmjet kërkesës së tyre në këtë Gjykatë ka zgjatur rreth 3 vjet. Në vlerësimin e Gjykatës, kjo është një periudhë kohore e arsyeshme për shqyrtimin e çështjes nga gjykatat e zakonshme, për më tepër që ajo nuk ka konstatuar cenim të së drejtës së pronës në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesve. Për këtë arsye, Gjykata

çmon se edhe ky pretendim i kërkuesve është i pabazuar.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve nuk janë të bazuara dhe kërkesa e tyre duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.2.2021.

Shpallur më 16.3.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Përparim Kalo

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Neni 132 i ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 104, viti 2020, të ndreqet si më poshtë:

“Neni 132

Kushtet për regjistrimin e fondeve të investimeve alternative të huaja

1. Regjistrimi i fondit të investimeve alternative të administruar nga një administruer i huaj i fondeve të investimeve alternative miratohet nga autoriteti, vetëm nëse:

a) administruer i fondeve të investimeve alternative është në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji;

b) administruer i fondeve të investimeve alternative ndërmerr hapat e nevojshëm për të



kryer pagesat e investitorëve në Republikën e Shqipërisë, për të shlyer pjesëmarrjet dhe për të mundësuar informacionet që administruesi i fondeve të investimeve alternative duhet të hartojë, sipas rregullave të vendit të tij të origjinës;

c) vendi i origjinës i fondit të investimeve alternative nuk është i përfshirë në listën e vendeve jobashkëpunuese nga Task-Forca e Veprimit Financiar për Pastrimin e Parave (FATF-ML);

ç) fondi i investimeve alternative dhe administruesi i fondit të investimeve alternative janë objekt i një mbikëqyrjeje të duhur në vendin e origjinës dhe i përmbushin kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë tregtare në vendin e origjinës;

d) administruesi i fondeve të investimeve alternative është në përputhje me dispozitat e seksionit 3, të këtij kreu, dhe me parashikimet e nxjerra në bazë të tij;

dh) janë përmbushur kërkesat e shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji.

2. Autoriteti mund të miratojë rregulla të mëtejshme për vendosjen e kushteve të regjistrimit në bazë të pikës 1, të këtij neni, për të garantuar mbrojtjen e investitorëve në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe kushtet që vendosin detyrimin për informim të investitorëve dhe autoriteteve publike dhe lidhur me mënyrën si duhet të kryhet shitja e pjesëmarrjeve në Republikën e Shqipërisë.”

KËRKESË

Shtetasi Rrok Zefi kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë vërtetimin e faktit juridik të vdekjes së të ndjerit Zef Lazer Zefi, vdekur më datë 13 korrik 1997.

KËRKUES

Rrok Zefi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë